



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.3 Prot.

Tepelenë, më 29.03.2024

PROÇES – VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

Në datën 29.03.2024, në Pallatin e Kulturës Tepelenë, në katin e dytë, u zhvillua mbledhja e Këshillit Bashkiak Tepelenë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit në përputhje me Nenin 53, pika 3, gërma a, dhe Pika 4 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, si dhe "Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak".

Renditja e ditës përfshin:

- 1.Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, datë 27.02.2024.
- 3.Miratimi i ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Shkurt 2024.
- 4.Dhënia e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Shkurt 2024.
5. Miratimi i parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe tavanëve përgatitore të PBA 2025-2027.
6. Miratimi në parim të rrugës së kalimit servitutit publik në fshatin Nivice, Njësia Administrative Kurvelesh.

Kryetari i Këshillit, Z. Arben Gumeni, drejtoi mbledhjen, e cila nisi në orën 11:00. Këshilltarët pjesëmarrës ishin si vijon:

Latif Kaçaj

Mirela Varfi

Mjaftoni Zeraj

Matilda Çela

Vladimir Bakiaj

Esmeralda Bishani

Ilir Haska

Besnik Mece

Vladimir Gjonca

Ditar Hodaj

Dino Selimi

Arben Gumeni

Marsela Balili

Besnik Maca

Administrata e Bashkisë ishte prezente me:

Gëzim Shehu

Spiro Kora

Armand Sala

Hapja e mbledhjes:

Kryetari i Këshillit, Z. Arben Gumeni, deklaroi hapjen e mbledhjes dhe paraqet rendin e ditës.

Rendi i Ditës:

Miratimi i rendit të ditës.

- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë 27.02.2024.

Votimi për miratimin e rendit të ditës:

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.

Vota PRO: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Arben Gumeni, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e dytë e rendit të ditës: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë 27.02.2024.

Kryetari i Këshillit u drejton pyetje këshilltarëve në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Këshilltarët shprehin dakordësinë për përmbajtjen e procesverbalit.

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Vota PRO: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Arben Gumeni, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e tretë e rendit të ditës: Miratimi i ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Shkurt 2024.

Kryetari i Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë, e cila tha se komisioni u mbledh, u njoh me materialin dhe vendosi miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% për muajin Shkurt 2024.

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij projektakti.

Vota PRO: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Arben Gumeni, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e katërt e rendit të ditës: Për dhënien e ndihmës ekonomike përpërdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Shkurt 2024.

Kryetari i Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë, e cila tha se komisioni u mbledh, u njoh me materialin dhe vendosi miratimin e ndihmës ekonomike me fondin e bashkisë, për muajin Shkurt 2024.

Fjalën e mori Këshilltari Vladimir Bakiaj: - Në listat e Njësisë Qendër ka shumë persona që trajtohen me ndihmë ekonomike, kam rezerva.

Armand Sala: - Në lidhje me Njësinë Qendër, në bazë të kërkesave jepet ndihma ekonomike. Ka dhe familje në nevojë që nuk paraqiten tek zyrat e ndihmës ekonomike; ato familje nuk mund të trajtohen.

Fjalën e mori Këshilltari Vladimir Bakiaj: - Po ka të punësuar në familje të mos trajtohen me ndihmë ekonomike.

Fjalën e mori Kryetari i Këshillit, Z. Arben Gumeni: - Këto familje që trajtohen kanë kritere, pagesat janë të ulëta. Ne kemi kërkuar të rritet kjo pagesë. Ne nuk heqim familje nga lista, fondi i Bashkisë është i përcaktuar në buxhet.

Armand Sala: - Do bëhet verifikim i listës në Njësinë Qendër.

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij projektvendimi.

Vota PRO: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e pestë e rendit të ditës: Për miratimin e parashikimeve afatmesme të të ardhurave dhe taveve përgatitore të PBA 2025-2027.

Fjalën e mori Z. Spiro Kora, i cili raportoi materialin (bashkëlidhur).

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo.

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij projektvendimi.

Vota PRO: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balil.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e gjashtë e rendit të ditës: Për miratimin në parim të rrugës së kalimit servitut publik, ndodhur në fshatin Nivicë, Njësia Administrative Kurvelesh.

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Rural, Z. Gëzim Shehu: - Tek projektvendimi keni një kërkesë që ka ardhur nga subjekti Albvil Shpk, i cili në pasurinë që ka marrë me qira ka nevojë për një rrugë kalimi që të përdorë pronat e marra me qira. Duke qenë se në hartë nuk ka rrugë ekzistuese, ka kërkuar miratimin e rrugës tokë shtet.

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Ka pronar kjo rrugë? Cila pjesë është? Ka konflikt?

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Rural, Z. Gëzim Shehu: - Kjo rrugë është në Stog, është pronë shtet në certifikat të Bashkisë, nuk ka konflikt. Është rrugë ekzistuese në terren përdorur prej disa vitesh.

Fjalën e mori Z. Ditar Hodaj: - Atje ka rrugë, e kam parë.

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Rural, Z. Gëzim Shehu: - Rruga është në terren, duhet hedhur në hartë që të jetë e ligjshme.

Kryetari i Këshillit: - Bëhet fjalë për një rrugë në fshatin Nivicë në pasuritë që ka marrë me qira. Ne kemi detyrim ligjor ta miratojmë servitutin për çdo investitor.

Fjalën e mori Znj. Marsela Balil: - Ku ka kaluar më parë?

Kryetari i Këshillit: - Aty ka kaluar, dhe e kërkon të bëhet me vendim.

Kryetari i Këshillit: - Ne kemi dhënë servitut kalimi dhe për rrugë shtëpie, rruga për të vajtur në pronë është detyrim ligjor.

Fjalën e mori Z. Latif Kacaj: - Mos të preket prona e tjetrit.

Fjalën e mori Z. Gëzim Shehu: - Është pronë shtetërore.

Fjalën e mori Z. Vladimir Bakiaj: - Jam dakord, rruga të hapet.

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij projektvendimi.

Vota PRO: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

➤ Çështje të tjera:

Kryetari i Këshillit: Kërkesë nga Shoqata Labëria Dega Tiranë për propozim për miratim të ngritjes së memorialit/shtatores së kapiten Memo Nexhipit, Heroit të Popullit dhe Dëshmorit të Atdheut në fshatin e tij të lindjes në Dukaj të Tepelenës që ra heroikisht në Vidohovë më 2.8.1949. Kjo nuk është kompetencë e jona, t'ja kalojmë zyrës përkatëse në Bashki ta diskutojë, dhe kur të jetë gati të paraqitet në këshill për miratim (bashkëlidhur kërkesa).

Kërkesë nga Z. Ylli Merja për vendosjen e një pllake përkujtimore "Sheshi Bregu Merje" në fshatin Nivicë (bashkëlidhur kërkesa). Kjo kërkesë të shkojë në Bashki zyra përkatëse të bëjë verifikimet e duhura, pastaj të paraqitet në këshill për miratim.

Ankesë nga Z. Erjon Shehu, banor i qytetit Tepelenë Lagj: "Mustafa Matohiti" apartamenti nr. 9 në lidhje me strehën që ka vendosur komshiu Z. Dritan Bektashi (bashkëlidhur kërkesa). Ne si këshill të ngremë një komision me tre anëtarë i cili ti bashkohet grupit të punës së Bashkisë.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela: Këto streha duhet të jenë, është marrë leje nga bashkia?

Kryetari i Këshillit: - Këto streha janë shqetësuese për pallatin.

Fjalën e mori Z. Vladimir Bakiaj: Me këtë ankesë të merret aparati i bashkisë, jo grup pune nga këshilli.

Kryetari i Këshillit: - Do caktojmë tre anëtarë këshilli grup pune, bashkë me grupin e punës së bashkisë, për verifikim në terren.

Propozoj: Dino Selimi, Esmeralda Bishani, Vladimir Bakiaj.

Hidhet në votim grupi i punës dhe miratohet (Vladimir Bakiaj nuk pranon).

Kërkesa e Z. Arqile Done për riparim rruge - Do t'i delegohet aparatit të Bashkisë.

Kërkesa e Z. Rapi Mece dhe Adile Mece për riparim çatie - Do t'i delegohet Bashkisë për verifikimet përkatëse.

Ankesa e Znj. Arta Seferi për konflikt me komshiun Z. Shkëlqim Kalemi - Grupi i punës së Këshillit dhe Bashkisë do të bëjnë verifikimet në terren.

Propozimi i Shoqatës Lopësi për titull qytetar nderi - Do të kalojë në komisionin e Bashkisë, e më pas do të paraqitet në Këshill për miratim.

Kërkesa e Organizatës së Veteranëve, Shoqata Labëria për rivendosje pllake tek Lisat e Kadhë dhe përkujtim të 12 Majit 1911 - Do të kalojë në zyrën përkatëse të bashkisë, e më pas do të paraqitet në Këshill për miratim.

Kërkesa për emërtimin "Sheshi Ali Beqaj" të sheshit kryesor në fshatin Nivicë - Do të kalojë në zyrën përkatëse të Bashkisë, e më pas do të paraqitet në Këshill për miratim.

Kryetari i Këshillit: Dje u mbledh komisioni i monitorimit të zgjedhjeve të strukturave komunitare të Bashkisë Tepelenë për ankesat e Z. Fatmir Çela dhe Z. Petrit Pila, lidhur me zgjedhjet e kryesisë së fshatit Turan. Ne diskutuam në komision duke u mbështetur në rregulloren "Për strukturat komunitare dhe ndërveprimi i tyre në Këshillin Bashkiak", neni 16 përberja e kryesisë, pika 2: Këshilli komunitar përbehet nga kjo kategori antarësh: banorë të lagjes të punësuar ose jo, banorë që zoterojnë prona të palujtshme në lagje, dhe tek neni 59 i kësaj rregullore; ankesat për procesin e votimit.

Komisioni vendosi me shumicë votash që të ngelet në fuqi VKB Nr. 89, datë 30.11.2023 "Për miratimin e kryesisë dhe kryetarëve të fshatrave të Bashkisë Tepelenë", me 13 vota pro dhe 1 kundër.

Vendimi i dytë i këshillit bashkiak i parregullt, ankesa do kalonte në komision pastaj në këshill Ankuesit t'i drejtohen Gjykatës Administrative, ne si këshill e kemi mbyllur këtë proces.

Duke parë p/verbalin e mbajtur në datë 12.09.2023 në zgjedhjet e kryesise dhe K/ Fshatit Turan Z. Fatmit Cela ka votuar dhe ka firmosur P/Verbalin e mbledhjes.

Mbyllet mbledhja ora 12.10

SEKRETARE E KËSHILLIT

Valbona ÇELA



KRYETAR I KËSHILLIT

Arben GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.4 Prot.

Tepelenë, më 30.04.2024

PROÇES – VERBAL
(I zbardhur nga origjinali)

Procesverbal i Mbledhjes së Këshillit Bashkiak Tepelenë, i mbajtur sot, më:

Data: 30.04.2024

Ora: 10:00

Vendi: Pallati i Kulturës Tepelenë (kati i dytë)

Mbledhja e Këshillit Bashkiak Tepelenë u thirr nga Kryetari i Këshillit, në bazë të Nenit 53, pika 3, gërma a, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, si dhe "Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak", me këtë:

Rend Dite:

- Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
- Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar, datë 29.03.2024.
- Projektvendim: "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Mars 2024".
- Projektvendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Mars 2024".
- Projektvendim: "Për miratimin e pjesëmarrjes së Bashkisë Tepelenë në aktivitetin sportiv, 'Maratona Wild River'".
- Projektvendim: "Për miratimin e planit të përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollor në Bashkinë Tepelenë".
- Projektvendim: "Për dhënie titull nderi".
- Projektvendim: "Për emërtim rruge".
- Projektvendim: "Për miratim, në parim për zhvillimin e pasurive Nr. 818, 820, 172/4 (172-b) zona kadastrale Nr. 2807, në pronësi shtetërore, të administruara nga Bashkia Tepelenë,

si dhe autorizimin nga Bashkia Tepelenë për lejimin e zhvilluesit 'ALBVIL' shpk të aplikojë për paisjen e objektit/investimit/zhvillimit me lejen përkatëse, në portalin 'E-ALBANIA' rubrikën E-LEJE 'projektin e investimit, për implementimin e këtij projekti në territorin që është në juridiksionin e Bashkisë Tepelenë".

- Kërkohe mendimi i Këshillit Bashkiak Tepelenë për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërsve të ndotura".
- Kërkesë për bashkëpunim në realizimin e planit zhvillimor "Luzati në art"
- Çështje të tjera.

Kryetar i Këshillit Bashkiak Z. Arben Gumeni drejton mbledhjen.

Ora e hapjes së mbledhjes: 10:20

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes:

Latif Kaçaj
Mirela Varfi
Mjaftoni Zeraj
Matilda Çela
Vladimir Bakiaj
Esmeralda Bishani
Iilir Haska
Besnik Mece
Vladimir Gjonca
Ditar Hodaj
Dino Selimi
Arben Gumeni
Marsela Balili
Besnik Maca

Marrin pjesë nga Administrata e Bashkisë:

Julinda Karteri
Gëzim Shehu
Arta Shaha
Rovena Mullara
Festime Elezi

Kryetari i Këshillit Z. Arben Gumeni deklaroi hapjen e mbledhjes, paraqet rendin e ditës.

- Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.

Vota PRO: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Arben Gumeni, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e dytë e rendit të ditës: "Miratimin e procesverbalit të mbledhjeve të kaluara datë 29.03.2024"

Kryetari i Këshillit u drejtoi pyetje këshilltarëve, në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Këshilltarët shprehën dakortësinë për përmbajtjen e procesverbalit.

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Votimi i hapur

Vota PRO: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Çela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Arben Gumeni, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e tretë e rendit të ditës: "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Mars 2024"

Kryetari i Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetare Komisionit Ekonomisë: - Komisioni u mbledh, u njoh me materialin dhe vendosi miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% për muajin Mars 2024.

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij projektakti.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Arben Gumeni, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e katërt e rendit të ditës: "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Mars 2024"

Kryetari i Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela Kryetare Komisionit Ekonomisë: - Komisioni u mbledh, u njoh me materialin dhe vendosi miratimin e ndihmës ekonomike me fondin e bashkisë, pasi janë të njëjtat familje për muajin Mars 2024.

Fjalën e mori Këshilltari, Vladimir Bakiaj: - Në mbledhjen e kaluar kërkoja informacion për listat e personave që trajtohen me ndihmë ekonomike të Njësisë Administrative Qëndër, nuk kam marrë informacion, kam rezerva.

Kryetari i Këshillit: Po ka persona që trajtohen me ndihmë ekonomike që nuk u takon na i thuaj, ti verifikoj zyra përkatëse, pasi ata shkojnë në çdo familje që i verifikojnë.

Fjalën e mori Këshilltari, Vladimir Bakiaj: - Pyeta nëqse ka persona që janë në punë dhe trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë ose kanë pjesëtar të familjes të punësuar.

Fjalën e mori Znj. Rovena Mullara: Listat e personave që trajtohen me fondin e Bashkisë janë persona pa të ardhura, persona në gjendje të vështirë ekonomike, gra të divorcuara, persona të vetmuar pa të ardhura etj.

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij projektvendimi.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e pestë e rendit të ditës: “Për miratimin e pjesëmarrjes së Bashkisë Tepelenë në aktivitetet sportiv, "Maratona Wild River".

Fjalën e mori Znj. Julinda Karteri paraqet materialin (bashkëlidhur)

Jeni njohur me materialin e diskutuam dhe në komision është shoqata “Maratona Albania“ si anëtare e Federatës Shqiptare të Atletikës e cila na ka paraqitur një kërkesë për tu bërë pjesë e një aktiviteti të përbashkët për realizimin e Internacional Ultra Trail: Maratona “Vjosa Wilder River“. Shoqata ka certifikat nga organizata botërore e Maratonës me afat 5 vjekar dhe ky aktivitet do organizohet cdo vit në javën e fundit të muajit Gusht. Ky organizim të cilën e sollëm këtu ne si administrat për tu bërë pjesë dhe Bashkia Tepelenë, ka një promovim të madh, ku janë të gjitha bashkitë Përmet, Këlcyrë, Memaliaj dhe Tepelenë në vendin ku kalon Vjosa dhe gjithë ideja është që kjo maratonë do kaloj në gjithë fshatrat e bashkive tona duke promovuar traditën, historinë gastronominë dhe natyrën si një atraksion turistik dhe sportiv.

Ne jemi këtu si administrat për ta propozuar për të qënë pjesë e këtij aktiviteti sportiv që do të organizohet në të gjitha Bashkitë ku kalon lumi Vjosë.

Kryetari i Këshillit: Këto aktivitete janë të mirëpritura në Bashkinë tonë.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e këtij projekvendimi.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e gjashtë e rendit të ditës: “Për miratimin e planit të përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollor në Bashkinë Tepelenë”.

Fjalën e mori Znj. Arta Shaha relaton materialin (bashkëlidhur)

Qëllimi i planit të përmirësimit cilësinë e arsimit parashkollor në Bashkinë Tepelenë duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës kopshteve zhvillimin e burimeve njerëzore dhe krijimin e një databaze efektive për menaxhimin e strukturave të arsimit parashkollor. Ky plan synon të

harmonizojë aktivitetet në një vizion të përbashkët, duke përfshirë bashkëpunimin prindër dhe komunitet.

Plani i përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollor në Bashkinë Tepelnë përqëndrohet në procesin e menaxhimit të shërbimit në arsimin parashkollor me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe organizimit efektiv Planifikimi dhe kontrolli i cilësisë janë thelbësore për këtë qëllim, duke përfshirë planifikimin e numrit të fëmijëve në kopshte dhe vlerësimin e infrastrukturës së nevojshme.

Planifikimi dhe zbatimi i Proceseve Mbështetëse në Planin e Përmirësimit të Shërbimit për kopshtet publike të Bashkisë Tepelenë është një pjesë kritike e përpjekjeve për të siguruar një mjedis të përshtatshëm dhe cilësor për fëmijët. Këto procese janë themelore për arritjen e qëllimeve të përcaktuara, duke përfshirë trajnimin e stafit, përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve dhe sigurimin e materialeve didaktike. Qëllimi i Proceseve Mbështetëse është të ofrojnë mbështetje efektive për proceset kryesore të shërbimit në kopshte. Këto përfshijnë aspekte të rëndësishme si edukimi, siguria, zhvillimi dhe aksesueshmëria për të gjithë fëmijët.

Bashkia Tepelenë në bashkëpunim me këshillin bashkiak kanë zhvilluar dëgjese publike dhe mendimet e atyre që morën pjesë në këtë dëgjese janë paraqitur në këtë relacion

Fjalën e mori Znj. Mirela Varfi Kryetare Komisionit Arsim Kulturës: Komisioni shqyrtoi materialin, sygjerimet e dëgjësës publike të cilët u shprehën për; trajnime të vazhdueshme të stafit, shtimin e mësuesve ndihmës dhe psikologut në kopshte sic është në shkolla. Paisjen me mjete didaktike si në kopshtet e qytetit dhe të fshatit. Propozoj këshillit ta kalojmë këtë material për votim

Kryetari i Këshillit: Duke qënë se ky material është bërë me konsultim publik ta hedhim në votim.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e këtij projekvendimi.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

➤ Pika e shtatë e rendit të ditës: “ Për dhënie titull nderi”.

Fjalën e mori Znj. Arta Shaha: Pranë Bashkisë Tepelenë janë paraqitur kërkesa për dhënie titull nderi nga shoqata e zonës së Krahësit. Kërkesat kanë ardhur në Bashki dhe janë propozuar për në këshill bashkiak nga kryetari i Bashkisë Tepelenë. Janë verifikuar të gjitha kërkesat nga komisioni për dhënie të titujve të nderit dhe ju kanë ardhur ju për miratim. Kërkesat për titull nderi janë për Z. Fejzi Hazis Barjami, Z. Idajet Lame Barjami, Z. Xhevdet Veli Xhemali. Gjithashtu kemi dhe një propozim për dhënie titull qytetar nderi nga shoqata Lopsi për Z. Fatmir Elezi Mecaj i cili ka lindur në Lopës dhe ka punuar si ushtarak.

Fjalën e mori Znj. Mirela Varfi Kryetare Komisionit Arsim Kulturës: Komisioni shqyrtoi materialin e aparatit të Bashkisë, vendosi ta kaloj për miratim në këshill.

Fjalën e mori Këshilltari, Vladimir Bakiaj: Komisioni i bashkisë që kalon titujt e nderit duhet të jetë më i përgjegjshëm në kriteret për titull nderi. Të shikohet procedura e dhënies së titujve të nderit.

Fjalën e mori Këshilltari, Latif Kacaj: - Jam dakot me Ladin për procedurën e dhënies së titujve të nderit.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij projekvendimi.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

Kryetari i Këshillit: Propozoj dhënie titull nderi të jepen cdo 3 muaj ose 6 muaj, të jepen tre vlerësime tituj nderi, jepni mendime dhe ju.

Fjalën e mori Znj. Mjaftoni Zeraj: Jam dakort me mendimin e kryetarit të Këshillit, të jepen tituj nderi një herë në 6 muaj Këto janë figura të vlerësuara për bashkinë tonë pavarësisht sa e njohim ne aktivitetin e tyre. Komisioni i vlerësimit të figurave i ka vlerësuar këto persona për kontributin e dhënë

Kryetari i Këshillit: Vlerësimi për dhënie titull nderi të trajtohen një herë në 6 muaj.

Hidhet në votim miratohet 14 vota pro

- Pika e tetë e rendit të ditës: "Emërtim rruge"

Fjalën e mori Znj. Arta Shaha: Propozimi për emërtim rruge ka ardhur nga Njësia Administrative Kurvelësh, për emërtimin me emrin Halil Fuat Hodaj të rrugës sipas fragmentit të hartës bashkëlidhur në njësinë Administrative Kurvelësh si më poshtë;

Nga dalja e fshatit Gusmar deri në hyrje të fshati Nivicë të marë emrin: Halil Fuat Hodaj vendi ku zoti Halil Fuat Hodaj ka rënë Dëshmor.

Fjalën e mori Këshilltari, Latif Kacaj: Mos ka mbivendosje të rrugës?

Kryetari i Këshillit: Diskutuum në komision nuk ka mbivendosje është parë nga zyra përkatëse

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij projekvendimi.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 14

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e nëntë e rendit të ditës: "Për miratim, në parim për zhvillimin e pasurive Nr. 818, 820, 172/4 (172-b) zona kadastrale Nr. 2807, në pronësi shtetërore, të administruara na Bashkia Tepelenë si dhe autorizimin nga Bashkia Tepelenë për lejimin e zhvilluesit "ALBVIL" shpk të aplikojë për pajisjen e objektit/investimit/zhvillimit me lejen përkatëse, në portalin "E-ALBANIA" rubrikën "E-LEJE", projektin e investimit, për implementimin e këtij projekti në teritorrin që është në juridiksionin e Bashkisë Tepelenë"

Kryetari i Këshillit: Ky p/vendim është për miratim në parim për të kaluar disa pasuri për zhvillim.

Fjalën e mori Këshilltari, Ditar Hodaj: Ka konflikt midis palëve atje, ne miratuam rrugë kalimi

Gëzim; Nuk kanë konfliktë mes palëve.

Kryetare Komisionit Ekonomisë Znj Matilda Çela: Dje në komision me anëtarët e tjerë të komisionit kemi diskutuar, në momentin që nuk kemi materialin e plotë kemi qënë të paqartë për të vijuar më tej.

Fjalën e mori Këshilltari, Z. Vladimir Bakiq: Jo se nuk jemi dakort për zhvillim por të vi materiali i plote në kohë.

Kryetari i Këshillit: Ka ndonjë mendim tjetër, ta dëgjojmë Gëzimin

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Rural Z. Gëzim Shehu: Këshilli Bashkiak i lejon këtij zhvilluesi që të bëjë aplikimin në sistemin e lejeve, projekti shtëpiza të cmontushme për të cilat do aplikohet për deklaratë paraprake.

Fjalën e mori Këshilltari, Z. Latif Kacaj: Une mendoj ky material të kaloj në mbledhjen e radhës.

Kryetari i Këshillit: Të mblidhet komisioni të vlerësoj materialin dhe të vendosni do ta kaloni apo jo këtë material sot në këtë mbledhje. Ky p/vendim është në të mirë të bashkisë, për të kaluar në parim që ne këtë subjekt ta lejojmë të aplikoj për leje pasi është pajisur me kontratë qeraje nga bashkia. Ta hedhim në votim për tu futur si material në rendin e ditës.

Kryetare Komisionit Ekonomisë Matilda Çela: Komisioni vendosi të futet si material në rendin e ditës.

Fjalën e mori DPKZHT Z. Lorenc Bami: Sic kemi ndjekur gjithmonë procedurat në këshillin bashkiak vjen propozim për zhvillim pasurie që do ketë zhvillim, është në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë pronar i kësaj pasurie është Këshilli Bashkiak, i cili në bazë të legjislacionit është personi që jep të drejtat administratës së Bashkisë Tepelenë për të vepruar. Në lidhje me këtë rast Këshilli Bashkiak në pjesën ligjore për të zhvilluar atë pronë nuk e ka të drejtepërdrejt përgjegjësinë e mënyrës se dokumentacionit. Në këshill bashkiak ne kemi paraqitur dy gjëra kryesore, një pamje në pasurinë që do zhvillohet do bëhet ky lloj funksioni, zakonisht kemi paraqitur fotografi, projektide, dhe i është kërkuar këshillit bashkiak kjo zonë me këta të huaj lejohet të zhvillojnë me bujtina (ecoturizmi) forma zhvillimi në interes të Bashkisë dhe të komunitetit. Gjithmonë nga këshilli bashkiak kemi kërkuar miratimin në parim nuk kërkojmë nga këshilli bashkiak të miratoni këtë projekt dhe të mbani përgjegjësi për këtë projekt. Këshilli Bashkiak për këtë pronë që do zhvillohet të ketë dokortësinë në parim për të vazhduar procedurat.

Fjalën e mori Znj. Marsela Balili: Cfare do ndërtohet në këtë pronë

Fjalën e mori DPKZHT Z.Lorenc Bami: Në këtë pronë shtetërore që mund të jetë ose e bashkisë ose e shtetit që në këtë rast është pronë e shtetit kemi interes që të huaj të zhvillojnë. Natyra e zhvillimit janë shtëpiza druri të cilat po nuk do këshilli bashkiak vitin tjetër i heq, ky zhvillim është për një vit.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij projektvendimi.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 10

Latif Kacaj, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Matilda Cela, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Miftar Meta, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

Kryetari i Këshillit: Kërkohe mendimi i Këshillit Bashkiak Tepelenë për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura. Nga drejtoria Rajonale Gjirokastër ka ardhur një material ku është bërë një analizë për cmimet që janë dhe ato që do bëhen dhe kërkohet mendimi që do rriten tarifat për m³, nga 33 lekë në 50 lekë, dhe tarifa për largimin e ujrave të ndotura nga nga 12 lekë në 15 lekë. Nga Këshilli kërkohet mendim dhe do dërgojmë shkresë cfarë do vendosim. Unë kam bërë një analizë me specialist, duke ju referuar vitit 2013, për të gjitha njësitë. Ata kanë bërë një analizë, ne do bëjmë analizën tonë. Këto mendime do shkojnë tek ERRU.e cila do të vlerësoj dhe mendimin e Këshillit dhe të specialistit për të vendosur.

Fjalën e mori Znj, Celestina Dajlani Ing pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokasteë Sh.A .

Kemi ardhur për tju paraqitur situatën në lidhje me ujësjellës kanalizime për tarifat. Qeveria Shqiptare prej vitit 2022 ka reformuar sektorin e ujësjellës kamalizimeve, Ujësjellësit të Gjirokastrës i janë bashkuar dhe 6 njësi të tjera të qarkut, duke përfshirë këtu dhe njësinë Tepelenë. Sipas metodologjisë për vendosjen e tarifave të entit rregullator të ujit duhet patjetër që tarifat e ujit të jenë të miratuara nga enti rregullator, por si pjesë e procedurës që shoqëria duhet të paraqes tek enti duhet dhe mendimi i këshillave bashkiak të njëjësive përkatëse. Duke bërë një analizë financiare të shoqërisë ne kemi propozuar tarifat që ju keni në material, fatura e ujit të pijshëm do të shkojë nga 756 lekë me tvsh në 1176 lekë me tvsh kjo për një faturë mesatare 12 m³, supozojmë që gjithë abonentet do faturohen me matës.

Unë do përmend disa arsye financiare pse shoqëria rajonale ujësjellës kanalizime po bën propozimin për ndryshimin tarife sic e tha dhe kolegja është propozim. Shoqëria rajonale nuk është organ kompetent i cili miraton ndryshimin e tarifave, organi i cili në fund do japi vendimin është enti rregullator i ujit që mund të lëre tarifat që ne do propozojmë ose mund të gjykoj që të ketë ndryshime. Njësia Tepelenë nuk ka qëndrueshmëri financiare që do të thotë që njësia Tepelenë për vitin 2022, 2023 dhe në vazhdim nuk mbulon kostot operative, që do të thotë nuk mbulon shpenzimet për paga për energji elektrike për materiale dhe për investime. Duke mos mbuluar kostot operative nuk ka mbulim total as të kostos totale. Për të përmirësuar situatën financiare njësia Tepelenë mendohet të rregulloj planin e saj tarifor. Ky plan tarifor është miratuar dhe nga Këshilli mbikqyrës nëpërmjet planit të biznesit 5 vjeçar 2024 - 2028. Me ndryshimin e planit tarifor

mendohet që njësia Tepelenë të mbuloj të koston operative në masën 96%. Ndryshimi i tarifës sjell të ardhura më të larta për njësinë Tepelenë duke rritur faturimin dhe arkëtimin duke sjellë një përmirësim në rrjetin e ujit të pijshëm dhe duke menduar të kryhen investime për ti shërbyer komunitetit.

Fjalën e mori Këshilltari, Vladimir Bakiaj: - Në lidhje me materialin e ardhur nga shoqëria rajonale Gjrokastër kur e keni marrë ujesjellsin e Tepelenës a janë parë performancat e të gjitha shoqërive, si është performanca e gjithë ujesjellsave, si është ecuria deri sot. Ky material nuk ka lidhje me performancën për ngritjen e tarifave, performanca fillon nga numri i punonjësve

- Tek materiali është performance e njësisë Tepelenë tabela nr 4.

Fjalën e mori Këshilltari, Vladimir Bakiaj: - Ne kemi dy kaptazhe uji, ju kërkoni rritjen e cmimit të ujit nuk plotësohen kritere e shoqërisë tonë, nuk është arsye rritja e tarifës me rritjen e numrit të punonjësve.

Kryetari i Këshillit: Ne japim mendim dhe vlerësimin tonë të cilin do ta dërgojmë zyrtarisht në ditët në vazhdim pasi do marrim dhe mendimin e specilistëve të fushës.

- Abonentët më të shumtë janë në qytetin Tepelenë, 1923 abonentë duhet të bazohemi te cmimi i Tepelenës. Duke qënë se abonentët e qytetit janë 3/4 duhet marrë për bazë cmimi për m3 i qytetit Tepelenë, kostoja e cmimit për m3 në Tepelenë është 36 lekë m3 sot, sepse 1/4 (fshatrat) nuk vendos mbi 3/4 (qyteti).

-Harxhimi i energjise elektrike nga pompat në depot e ujit të njësisve administrative duhet të rinovohen, te zëvendësohen me pompa inverto ose me rreze diellore ku harxhimi i energjisë elektrike është i ulët. Për këto rinovime të kërkohet subvencion, nga shteti, në depot e ujit në fshatra duhet të kontrollohen me kamera, punonjësit te mos abuzohet me pompat.

Këshilli Bashkiak Tepelenë kërkon që cmimi për m3 te ujit nuk duhet të rritet mbi 30%, cmimi nga 33 leke m3 nuk duhet te kaloj 40 leke për m3. Cmimi per largimin e ujrave të ndotura nga 12 leke te behet 15 leke. Tarifa fikse nga 90 lekë deri në 120 lekë.

Këshilli kërkon nga ju për keto ndryshime të bëhet dëgjese publike me qytetarët e Bashkisë Tepelenë.

Celestina: Të shprehni mendimin tuaj pozitiv ose negativ në kthim përgjigje,

Kryetari i Këshillit: Kërkesë bashkëpunimi për realizimin e projektit "Luzati në art"

Aleksandër: Kërkesë nga fondacioni Kalo për zhvillimin e një projekti me disa komponentë i cili pritet të ndikojë në nivelin e jetesës në fshatin Luzat, duke e bërë atë tërheqës për vizitorët vendas dhe të huaj. Kjo kërkesë është për tu miratuar në parim nga ana juaj, bëhet fjalë për shkollën e Luzatit e cila është e mbyllur aktualisht sepse nuk ka nxënës që ndjekin shkollën në Luzat

propozimi është që shkolla mos të rri e mbyllur, por të zhvillohet në aspektin artistik pa u cënuar pa u ndryshuar por të jëtë funksionale për projekte rinore pa pagesë.

Fjalën e mori Znj. Matilda Çela: Shkolla është funksionale? Nuk ka nxënës?!

Alekddander: Jo nuk ka nxënës

Fjalën e mori Këshilltari, Z. Vladimir Bakiaj: Pronë e kujt është shkolla?

Aleksandër: Pronë e shtetit, është miratim në parim

➤ **Çështje të tjera**

Kryetari i Këshillit: -Kërkesë për dhënie ndihme financiare bashkëlidhur kërkesa

-Kjo kërkesë ti përcillet bashkisë zyra përkatëse për tu trajtuar me ndihmë financiare.

-Kërkesë nga Z. Veliko Gumeni për servitut rrugë kalimi për në shtëpi

Jemi dakort të bëhet projekti për servitut rrugë kalimi, zyra përkatëse të bej materialin gati të kaloj në këshill,

-Kërkesë nga Zj. Hava Caushi kërkon të marrë tokë bujqësore me ligjin 7501

Ky ligj nuk është në fuqi është shfuqëzuar në vitin 2020.

Mbyllet mbledhja e keshillit ora 12.35

SEKRETARE E KËSHILLIT

Valbona ÇELA



KRYETAR I KËSHILLIT

Arben GUMENI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.5 Prot.

Tepelenë, më 30.05.2024

PROÇES – VERBAL

(I zbardhur nga origjinali)

I mbajtur sot, më datë 30.05.2024, ora 10:00 në Pallatin e Kulturës Tepelenë (kati I dytë) në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Tepelenë thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Neni 53, pika 3, gërma a, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe “Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak” me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluara datë 30.04.2024.
3. Projektvendim: “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Prill 2024”.
4. Projektvendim: “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Prill 2024”.
5. Projektvendim: “Për miratimin e raportit për monitorimin e vlerësimin e buxhetit për periudhën 4 mujori i parë 2024”
6. Projektvendim: “Për miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit midis fondacionit Kalo dhe Bashkisë Tepelenë në kuadër të zbatimit të planit zhvillimor Luzatart”
7. Projektvendim: “Miratimin në parim për zhvillimin e pasurive nr.391/3, zona kadastrale nr.1529, në pronësi të Bashkisë Tepelenë si dhe autorizimin nga Bashkia Tepelenë për lejimin e zhvilluesit /investitorit Z. Spiro Qëndraj ose përfaqësuesi i tij të aplikojë për paisjen e objektit/investimit zhvillimit me lejet përkatëse, në portalin “E-ALBANIA” në rubrikën “E-LEJE”, për implementimin e këtij projekti në territorin që është nën juridiksionin e Bashkisë Tepelenë”

8. Çështje të tjera.

Kryetar i Këshillit Bashkiak Z. Arben Gumeni drejton mbledhjen.

Ora e hapjes së mbledhjes 10:20

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes:

- Mirela Varfi
- Mjaftoni Zeraj
- Vladimir Bakiaj
- Esmeralda Bishani
- Ilir Haska
- Besnik Mece
- Marios Jorgo
- Ditar Hodaj
- Dino Selimi
- Arben Gumeni
- Marsela Balili
- Besnik Maca

Marrin pjesë nga Administrata e Bashkisë:

- Spiro Kora
- Gëzim Shehu
- Aleksander Toti
- Rovenë Mullara
- Festime Elezi

Kryetar i Këshillit Z. Arben Gumeni deklaron hapjen e mbledhjes, paraqet rendin e ditës.


Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.

Vota PRO: 12

Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Arben Gumeni, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili, Marios Jorgo

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- 
- Pika e dytë e rendit të ditës: “Miratimin e procesverbalit të mbledhjeve të kaluara datë 30.04.2024”

Kryetari i Këshillit u drejton pyetje këshilltarëve, në lidhje me procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Këshilltarët shprehin dakortësinë për përmbajtjen e procesverbalit.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Votimi i hapur

Vota PRO :12

Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Arben Gumeni, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili.Marios Jorgo

Vota KUNDËR: S’ka

Vota ABSTENIM: S’ka

- Pika e tretë e rendit të ditës: “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Prill 2024”

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Komisioni u mbledh dhe shqyrtoi materialin është e njejta listë dhe vendosi miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% për muajin Prill 2024.

Fjalën e mori Këshilltari Znj. Mjaftoni Zeraj: - Është në skemën e ndihmës ekonomike Elvis Xhaferi?

Administrator Njësia Adm Lopës Znj. Festime Elezi: - Ky person është penalizuar për 6 muaj nga sistemi, kur ka bërë aplikim nuk ka deklaruar pensionin e babait,

Fjalën e mori Këshilltari Znj. Mjaftoni Zeraj: - Është familje në vështirësi ekonomike.

Fjalën e mori K/Këshillit Z. Arben Gumeni: - Këtë person mund ta trajtoni tek fondi i Bashkisë

Administrator Njësia Adm Lopës Znj. Festime Elezi: - Personi të paraqitet për aplikim, po nuk fitoi nga skema e ndihmës ekonomike të trajtohet me ndihmë ekonomike nga fondi i bashkisë.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e këtij projektakti.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 12

Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Marios Jorgo, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Arben Gumeni, Dino Selimi, Besnik Maca, Marsela Balili.

KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e katërt e rendit të ditës: “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Prill 2024”

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Komisioni u mbledh, dje u njoh me materialin dhe vendosi miratimin e ndihmës ekonomike me fondin e bashkisë, pasi janë të njëjtat familje për muajin Prill 2024

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje?

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e këtij projektvendimi.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 12

Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili. Marios Jorgo

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e pestë e rendit të ditës: “Për miratimin e raportit për monitorimin e vlerësimin e buxhetit për periudhën 4 mujorit të parë 2024”

Kryetari i Këshillit deklaron shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar Z. Spiro Kora: Relaton materialin (bashkëlidhur)

Paraqesim për miratim projektvendimin për miratimin e raportit për monitorimin e buxhetit për 4 mujorin parë 2024,

- Mbështetur në ligjin. Ligjin 139/2015 – datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore ”;
- Ligjin. Nr. 57/2016, datë 02.06.2016, Për disa shtesa e ndyshime, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në Republikën e Shqipërisë;
- Ligji nr. 68/2017, Për financat e vetëqeverisjes vendore
- V.K.B Nr 88, datë 30.11.2024. “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024”
- Udhëzimin Nr. 22 datë 30.07.2018, “Për procedurat standarte te monitorimit të Buxhetit të Njësive te Vetëqeverisjes Vendore”

Në zbatim të këtyrë kërkesave të ligjit Drejtoria e zhvillimit ekonomik me nr. 953prot. datë 15.5.2024 ka paraqitur pranë sekretares së këshillit bashkiak materialet e domosdoshme për këtë projektvendim (bashkëlidhur)

Fjalën e mori Këshilltari Z. Ditar Hodaj: - Varrezat e Kurveleshit, godina aty ose të rregullohet ose të priset.

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar Z. Spiro Kora: Ka përfunduar projekti është parashikuar rikonstruksion total, jemi në fazën e negocimit. Në kuadrin e 80 vjetorit të Clirimit të Atdheut Ministria e Mbrojtjes ka hapur një thirrje ne kemi aplikuar shpresoj të shpallemi fitues.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo

Fjalën e mori Këshilltarja Z. Esmeralda Bishani: Ndricimi në disa lagje në qytet mungon, të ndërhyhet në rrugët e brendshme të qytetit.

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij projektvendimi.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 12

Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili, Marios Jorgo

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e gjashtë e rendit të ditës: “Për miratimin në parim të marrëveshjes së bashkëpunimit midis fondacionit Kalo dhe Bashkisë Tepelenë në kuadër të zbatimit të planit zhvillimor Luzatart”

Fjalën e mori K/Këshillit Z. Arben Gumeni: - Ky material miratim në parim për një ambient tek shkolla në fshatin Luzat, janë 4 klasa, një klase cerdhe, dhe tre klasa bosh nuk ka nxënës, dhe kërkohet dhënia në përdorim e një klase nga fondacioni Kalo. Në komision u diskutua dhe u miratua si p/vendim

Ka pyetje?

Fjalën e mori Këshilltari Z. Ditar Hodaj: Unë kam problem në parim për të gjitha këto p/vendime janë bërë dëgjesa publike? Është zbatuar ligji me përpikmëri: Kam një problem me fshatin Nivicë, tek dhënia me qera, nuk ka rrugë kalimi të shikohet problemi dhe nqs duhet të kthehet nuk mund të ngrihen gjerdhet jashte kufijeve, nga 48 familje 42 janë kundër. Nuk e keni pyetur komunitetin që jeton aty, ka bagëti që do rruge të kalojë. I ktheni prap, si mund të jepni ju me qera? Ku do jetojnë ato familje? Të rishikohen me përparësi.

Është pyetur fshati Luzat, fshati Dragot, të rishikohet përsëri dhënia me qira në fshatin Nivicë.

Fjalën e mori K/Këshillit Z. Arben Gumeni: Për p/vendimin është marë mendimi nga kryesia e fshatit Luzat.

Fjalën e mori Këshilltari Z. Ditar Hodaj: Une dua ta kem përpara dokumentin e dëgjësës publike me firma.

Aleksandër: Në mbledhjen e kaluar ju paraqita një prezantim të kërkesës që ka ardhur nga fondacioni Kalo i cili meret me çështje të artit dhe kulturës ku së fundmi ata kanë marr një iniciativë për ta kthyer fshatin Luzat në fshat turistik.

Kam sjallë tek ju relacion për miratimin e marrëveshjes e cila nuk e kushtëzon në asnjë lloj forme cënimin e objektit. Objekti për tu vënë në dizpozicion për njerëzit të cilët vinë bëjnë takime ajo nuk do përdoret përdit por kur ka nevojë. Në bazë të kërkesës drejtuar zyrës arsimore për gjëndjen reale të shkollëve e cila thotë se nga viti 2016 shkolla është e mbyllur. Kjo është një kërkesë jo e jona, ne nuk kemi bërë shpallje që të themi kemi një shkollë dhe çfarë do bëjmë, por ka qenë kërkesë e vet fshatit për ta cuar përpara këtë iniciativë për turizëm në këtë zonë.

Kjo marrëveshje është për një periudhë tre vjecare dhe në rastin e parë që do ketë një kërkesë nga zyra arsimore ose Bashkiak për tu kthyer në gjëndjen e mëparshme që në atë moment shkëputet kontrata dhe do të filloj funksionin bazë.

Fjalën e mori Këshilltari Z. Dino Selimi: - Ambienti i asaj shkolle do jetë për muzeun?

Aleksander; Muzeu është bërë në vend tjetër, tek shkolla vetëm një dhomë do përdoret kur ka nevojë.

Fjalën e mori Këshilltari Z. Dino Selimi: - Izolimi i gjith shkollës është berë

Aleksander: Po

Për dëgjuesat publike neni 37 në rregulloren e këshillit bashkiak citon këshilli bashkiak mund të organizoj dëgjese nëse e sheh të nevojshme nqs ju kuptoni që këtu ka abuzim është këshilli që organizon dëgjuesën publike jo bashkia

Fjalën e mori Këshilltari Z. Ditar Hodaj: Jane dhënë toka me qera dhe nuk janë pyetur personat që jetojnë në atë tokë.

Fjalën e mori K/Këshillit Z. Arben Gumeni; Ne si keshill nuk kemi dhënë asnjë tokë me qera dhe nuk do japim pa dëgjese publike. Për të gjitha tokat e dhëna me qera do ti kërkojmë Bashkisë një informacion çfarë është bërë me këto toka sepse tokat janë dhënë me një plan, kanë paguar detyrimet taksat.

Fjalën e mori Këshilltari Z.Ditar Hodaj: - Kush del jashte territorit ti kthehet kontrata.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e këtij projekvendimi.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 12

Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili, Marios Jorgo

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

- Pika e shtatë e rendit të ditës: "Miratimin në parim për zhvillimin e pasurive nr. 391/3, zona kadastrale nr.1529, në pronësi të Bashkisë Tepelenë si dhe autorizimin nga Bashkia Tepelenë për lejimin e zhvilluesit /investitorit Z. Spiro Qëndraj ose përfaqësuesi i tij të aplikojë për paisjen e objektit/investimit zhvillimit me lejet përkatëse, në portalin "E-ALBANIA" në rubrikën "E-LEJE", për implementimin e këtij projekti në territorin që është nën juridiksionin e Bashkisë Tepelenë"

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Rural Z. Gezim Shehu: Është një kontrë qiraje që është dhënë në vitin 2018 me procedura ligjore për marrjen me qera të fondit kullosor për zhvillimin e turizmit, është në vazhdim duke qënë se është kontratë një vjecare dhe subjekti që e ka me qera ka bërë një projekt dhe kërkon të aplikoj për leje. Duke qënë se është pronë publike do miratimin që të lejohet të aplikoj në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit dhe pastaj shqyrtohet projekti nga të gjitha institucionet për miratim. Kjo pronë ndodhet tek ura e Dragotit projekti ndërtim me dy kate.

Fjalën e mori Këshilltari Z. Dino Selimi: Ne jemi dakort për zhvillim në Tepelenë unë jam dakort

Fjalën e mori Këshilltari Z. Ditar Hodaj: Ky ka pasur kontrat më parë?

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Rural Z. Gezim Shehu: Po ka pasur kontrat që në vitin 2018, por nuk e ka zhvillur për pamundësi financiare

Fjalën e mori Këshilltari Z. Ditar Hodaj: Sa vjecare ka qënë kontrata?

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Rural Z. Gezim Shehu: Kontrata 10 vjecare

Fjalën e mori Këshilltari Z. Ditar Hodaj: Po 6 vjet cfare ka bërë ky zoteri me tokën?

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Rural Z. Gezim Shehu: Ka pasur disa probleme pronësie të cilat janë zgjidhur në gjykatë, nuk ka pretendime pronësie

Fjalën e mori Këshilltari Z. Ditar Hodaj: Në kontrat nuk parashikohet fillimi i investimit, të vendoset në kontrat kushti i kohës brenda vitit të parë nëse nuk fillon investimin të vendoset gjobë.

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Rural Z. Gezim Shehu: Ai ka bërë punime ka mare leje për rrethimin dhe deklaratë për strukturat e cmontushme.

Fjalën e mori Këshilltari Z. Vladimir Bakiaj: Kur fillon projekti, mos fillojnë probleme të tjera me fshatin?

Fjalën e mori Drejtori i Zhvillimit Rural Z. Gezim Shehu: Ka pasur konflikte por janë zgjidhur ndaj është vonuar dhe zhvillimi. Ka kontratën në fuqi pronën të rrethuar ka bërë punimet me leje sistemim rrethim etj

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje? Jo

Kryetari i Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e këtij projekti.

-Votimi i hapur

Vota PRO: 12

Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Bakiaj, Ilir Haska, Esmeralda Bishani, Ditar Hodaj, Miftar Meta, Dino Selimi, Arben Gumeni, Besnik Maca, Marsela Balili, Marios Jorgo.

Vota KUNDËR: S'ka

Vota ABSTENIM: S'ka

➤ Çështje të tjera

Kryetari i Këshillit: Proropozim për miratimin te ngritjes së bustit të Kapedanit dhe prijesis të cetës Bilbilenjve, Bilbil SHAKO (1832-1858) në fshatin Rexhin të Tepelenës i cili u ekzekutua nga osmanet me varje në litar.

Këtë kërkesë t'ja delegojme aparatit të bashkisë zyra përkatëse të përgatis p/vendim për vendin në fshatin Rexhin ku do të vendoset busti.

Mbyllet mbledhja e këshillit ora 11.20

SEKRETARE E KËSHILLIT

Valbona ÇELA

KRYETAR I KËSHILLIT

Arben GUMENI

